



Агенција за вработување на  
Република Македонија

Në bazë të Planit operativ të programeve dhe masave aktive të punësimit gjatë vitit 2012, të paraparë me Programin e Punës së Qeverisë të Republikës së Maqedonisë 2011-2015 për masën aktive **Stërvitje për përmbushjen e profesioneve të kërkuara në tregun e punës**, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë, më datën 06.02.2012, bën

## **SHPALLJE PUBLIKE**

për

personat e evidentuar si të papunësuar

1. U bëhet thirrje personave të evidentuar si të papunësuar, të cilët janë të interesuar për aftësim profesional të marrjes së njohurive dhe aftësive për profesionet që kërkohen në tregun e punës, që më së voni deri më 20.02.2012, të paraqiten në klubet e punës së qendrave të punësimit ku janë të evidentuar si të papunësuar. Stërvitjet që do të bëhen nga ana e institucioneve arsimore ose institucioneve të arsimit, kanë të bëjnë me këto profesione dhe qytete siç vijojnë:

- elektroinstalues dhe elektromontues për objekte banesore (Shkup, Manastir, Kumanovë, Kaçan, Shtip)
- elektroinstalues dhe elektromontues për objektet industrialetë (Shkup, Strumicë, Kumanovë, Prilep, Shtip)
- instalues dhe montues të rrjetit ujësjellës dhe gazsjellës (Shkup)
- servisuues të sistemeve mekatronike (Shkup, Ohër)
- saldues me argon (Shkup, Shtip, Manastir)
- gjipspunues – montues (Tetovë, Shkup)
- kamarier – kuzhinier (Ohër, Gjevgjeli)
- ngjitës të pjesëve të sipërme të mbathjeve (Kumanovë)
- ndihmëskozmetist (Ohër)
- infermier të institucionit shëndetësor (Shkup, Manastir, Shtip)
- përkujdesëse patronati (Shkup, Tetovë)
- përpunues të prodhimeve të zdrucktariisë (Shkup, Koçan, Kumanovë, Manastir, Shtip, Gostivar)
- përpunues dhe montues të zdrucktariisë ndërtimore (Shkup, Kavadar, Strumicë)
- përpunues perimesh (Strumicë)
- autoservisuues ndreqjesh të vogla (Shkup, Veles)
- përpunues gatesash të bardha (Veles, Shkup, Tetovë, Strumicë)
- gatues të objekteve hotelerike (Gjevgjeli, Tetovë, Strumicë)
- floktar grash (Kumanovë, Prilep, Shtip)

2. Stërvitjet do të realizohen në shkollat e mesme të verifikuara ose në institucionet e licensuara për arsimimin e të rriturve, në një kohëzgjatje prej tre muajsh. Pas mbarimit të stërvitjes, kandidatët do të bëjnë punë praktike te punëdhënësit në kohëzgjatje prej një muaji.

3. Persoant e papunësuar që do ta kryejnë stërvitjen, punën praktike dhe që do ta japin me sukses provimin e paraparë, do të marrin dokumentin adekuat të lëshuar nga mbajtësi i verifikuar dhe i licensuar i stërvitjes.

Informata të hollësishme mund të merren në klubet e punës së qendrave të punësimit të qytetit të Shkupit, Manastirit, Velesit, Gjevgjelisë, Gostivarit, Kavadarit, Koçanit, Kumanovës, Ohrit, Prilepit, Strumicës, Tetovës dhe Shtipit, ku personat janë të evidentuar si të papunësuar. Telefoni i kontaktimit është 02-3298-297 dhe ueb faqja [www.avrm.gov.mk](http://www.avrm.gov.mk)

AGJENCIA E PUNËSIMIT  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË